



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

NR. ____, DATË ____/____/2025

**PËR MIRATIMIN E FUNKSIONIMIT TË QENDRËS “FUQIZOJMË KOMUNITETIN”
ME MBËSHTETJEN NGA PROGRAMI I FONDIT SOCIAL TË BUXHETIT TË
SHETIT PËR VITET 2025-2027 DHE BUXHETI I BASHKISË Durrës.**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Deklaratën e Përgjithshme të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, ligjit nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, VKM-së nr. 658, datë 17.10.2005 “Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”, Udhëzimin nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Qendrat Komunitare Shumëdisiplinore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.95, datë 28.10.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë”, Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Bashkisë dhe UNDP Shqipëri nr.2327 prot., datë 01.03.2023, Marrëveshjen e bashkëpunimit nr 605, datë 15.01.2025 të lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shërbimit Social Shtetëror “Për zbatimin e projektit “Shërbim i integruar për fuqizimin e individëve në nevojë”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe ;

TË VENDOSË:

1. Miratimin e funksionimit të Qendrës “Fuqizojmë Komunitetin” me një strukturë prej 15 punonjësish.
2. Miratimin e fondit prej 10,278,097 lekë për financimin e shpenzimeve të personelit për Qendrën “Fuqizojmë Komunitetin” për vitin 2025.
3. Miratimin e përdorimit të fondit prej 6,610,177 lekë që financohet nga Fondi Social i buxhetit të shtetit për financimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore për 7 punonjës.

4. Miratimin e fondit prej 3,667,920 lekë që do të financohet nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 që do të përdoret për financimin e shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore) për 8 punonjës, si më poshtë:

Kodi Njesisë shpenzuese	Njësia shpenzuese	Program buxhetor	Llogaria ekonomike	Fondi
2107017	Qendra Ditore të Moshuarve	10430	600	3,143,050
2107017	Qendra Ditore të Moshuarve	10430	601	524,870

5. Veprimet financiare të kësaj qendre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të të Moshuarve.

6. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Qendra Ditore e të Moshuarve, Bashkia Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtör
Alneida Rroshi

DR. E SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtör
Meme Xhaferaj

DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtör
Valbona Qiriako

DR. E B. NJERËZORE

Drejtör
Dhurata Gjoka

KRYETAR

Emiriana Sako